



Australian Government

## COVID-19 VACCINATION

# Efektet afatgjate të COVID-19

Shumica e njerëzve që kapin COVID-19 do të kenë simptome për një kohë të shkurtër dhe pastaj ndjehen më mirë brenda disa javëve. Koha që nevojitet për t'u ndjerë më mirë nga COVID-19 dallon tek secili person. Kjo varet nga ajo se sa të sëmurë keni qenë me COVID-19. Gjithashtu mund të varet se a keni ndonjë gjendje tjetër ekzistuese mjekësore.

Ka disa njerëz që përjetojnë probleme shëndetësore afatgjate pasi të kenë pasur COVID-19. Ndonjëherë COVID-19 shkakton që një person të mos ndjehet mirë për disa muaj pasi të jetë fillimisht i sëmurë. Kjo quhet 'COVID afatgjatë'. COVID-i afatgjatë mund të zgjas disa javë dhe muaj, edhe nëse personi më nuk e ka virusin.

Edhe njerëzit që kanë pasur infeksion të butë të COVID-19 dhe nuk kanë pasur nevojë të shkojnë në spital përsëri mund të kenë COVID afatgjatë.

### Simptomat e COVID-it afatgjatë

Shenjat dhe simptomat e zakonshme që mund të zgjasin pasi që njerëzit të infektohen janë:

- plogështi
- frymëmarrje të vështirësuar
- kollitje të vazhdueshme
- dhembje gjoksi
- dhembje të nyjeve
- energji të pamjaftueshme për të ushtruar
- ethe
- kokëdhembje
- problem me memorien dhe vështirësi për të menduar qartë ('mjegull në tru')
- depresion apo ankth.

Shumë efekte anësore afatgjate nga COVID-19 akoma janë të panjohur. Për këtë është me rëndësi të bëni gjithçka që është e mundur për të mbrojtur vetën që të mos infektoheni me virusin COVID-19.

Vaksinimi është mënyra më e mirë për të reduktuar rreziqet nga COVID-19.

Kur shumë njerëz do të vaksinohen kundër COVID-19, do të ulet rreziku i përhapjes në komunitet. Kjo çon në numër më të vogël të njerëzve të infektuar me COVID-19, e që zvogëlon numrin e njerëzve që përjetojnë COVID-in afatgjatë.

## Për më shumë informacione

Nëse keni pyetje, bisedoni me mjekun tuaj, vizitoni [health.gov.au/covid19-vaccines-languages](https://www.health.gov.au/covid19-vaccines-languages), apo thirrni Linjën kombëtare për ndihmë për koronavirus në 1800 020 080. Për shërbime përkthimi, thirrni 131 450.